



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave dhe Transfereve - Ministarstvo za Finansije i Transfere - Ministry of Finance and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



UDHËZUES PËR KOMPENSIM TË QIRASË

Prill 2020

Përmbajtja

Lista e figurave	2
1.Hyrje.....	3
2.Kërkesa për kompensim të qirasë.....	3
SHTOJCA 1 – Kompensimi i qiramarrësve.....	12

Lista e figurave

Figura 1:Menyja për kërkesën për kompensim të qirasë	3
Figura 2:Faqja për kërkesën për kompensim të qirasë.....	4
Figura 3:Tabela ne Excel për listimin e qiradhënësve për kompensim të qirasë.....	4
Figura 4:Faqja për kërkesën për kompensim të qirasë.....	6
Figura 5:Konfirmimi i kërkesës për kompensim të qirasë të regjistruar me sukses	7
Figura 6:Kërkesa për kompensim të qirasë, e shkarkuar me shtypjen e butonit "Shtyp Kërkesën"	8
Figura 7:Faqja për shtimin e kontratës së qirasë	9
Figura 8:Zgjedhja e kontratave për ngarkim	10
Figura 9:Kontrata e ngarkuar për qiradhënësin e caktuar	11
Figura 10:Kontrata e ngarkuar me sukses për qiradhënësin e caktuar	11

1.Hyrje

Ky udhëzues shërben për të gjithë tatimpaguesit, të cilët kanë pasur ndikim negativ nga situata e emergjencës shëndetësore me vendimet e Qeverisë së Kosovës për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, me ç' rast ju nevojitet kërkesa për kompensim të pagave të punëtorëve apo qirasë sipas Planit Operacional për Pakon Fiskale Emergjente – COVID-19.

Fillimisht shfrytëzuesi duhet të ketë llogari të hapur në EDI (Shërbimet elektronike/EDI-Deklarimi elektronik), në mënyrë që të kyçet dhe të ketë mundësi që t'i bëjë kërkesat në fjalë.

Në vazhdim janë shpjeguar hap pas hapi udhëzimet e nevojshme për ta bërë kërkesën për kompensim të qirasë.

2.Kërkesa për kompensim të qirasë

Për të bërë kërkesën për kompensim të qirasë, shfrytëzuesi duhet të navigojë tek menyja Shërbimet/Kërkesë për Kompensim të Qirasë (e shënjuar me ngjyrë të kuqe), sikurse në figurën vijuese:




Figura 1:Menyja për kërkesën për kompensim të qirasë

Për vëmendjen tuaj gjatë plotësimit të listës së qiradhënësve:

1. Gjatë plotësimit të informatave për qiradhënësit, duhet pasur kujdes sepse çdo mospërputhje /pasaktësi e NUI/NRF/ID e qiradhënësit dhe numrit të xhirollogarisë bankare rezulton me pamundësi të ngarkimit të Excel fajllit në formular, si dhe ekzekutimit të mjeteve financiare në llogarinë e duhur!
2. Qiramarrësi është i obliguar që me rastin e parashtrimit të kërkesës për kompensim të qirasë, të ngarkoj edhe kontratën e qirasë, të lidhur në mes tij dhe të qiradhënësit. Nëse kontrata nuk është e ngarkuar, kërkesa do të konsiderohet jo e kompletuar.

Për të krijuar një kërkesë të re, shtypet në butonin “Kërkesë e Re”, me ç ‘rast edhe hapet faqja ku shfrytëzuesi duhet ta plotësojë kërkesën me të dhënat përkatëse (shih në figurën 4 fushat e shënuara me ngjyrë të kuqe), duke ngarkuar Excel fajllin me qiradhënësit të cilët janë aktiv dhe për të cilët nevojitet kompensimi i qirasë.

Paraprkisht, duhet të lexohen me kujdes udhëzimet të cilat vlejné për qiradhënësit që duhet t’u kompensohet qiraja!

Kërkesë për kompensim të qirasë

Numri Fiskal

Emri i tatimpaguesit

Adresa e tatimpaguesit

Zgjedh Excel listën 

 Deklaroj se kontrata është lidhur me qiradhënësin para datës 1 Mars 2020 dhe është aktive.

 Deklaroj se veprimtaria e biznesit tim është ndikuar negativisht nga situata e emergjencës shëndetësore me vendimet e Qeverisë së Kosovës për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19: në mënyrë direkte (duke u përfshirë në listën e kodeve të veprimtarisë, të cilat janë ndaluar me urdhëresë të MEPTINIS të datës 23 Mars 2020); në mënyrë indirekte.

Në vijim ju lutem sqaroni me fjalë tuaja se si ju ka ndikuar në biznes vendimi i Qeverisë në mënyrë direkte apo indirekte dhe evidentoni të gjitha dëshmitë e mundshme, referuar vendimit të Ministrisë së Financave dhe Transfereve të datës 3 Prill 2020:




Figura 4: Faqja për kërkesën për kompensim të qirasë

Ngarkohet Excel fajlli me të dhënat e plotësuara dhe plotësohet fusha e komentit në lidhje me vështirësitë financiare të tatimpaguesit.

Shtypet në butonin “Dërgo listën”, dhe shfaqet faqja ku konfirmohet se kërkesa është regjistruar me sukses:




Figura 5:Konfirmimi i kërkesës për kompensim të qirasë të regjistruar me sukses

Në figurën 5, shfaqen butonat “Shtyp Kërkesën”, që mundëson shkarkimin e kërkesës(shih fig. 6) e cila mund të shtypet pastaj, “Kthehuni në listë”, për t’u kthyer tek lista (si në fig. 2) dhe “Ngarko Dëshmitë/Kontratrat” për t’u hapur faqja për të bashkangjitur kontratën/at e qirasë (si në fig.7).



Kërkesë për kompensim të qirasë

(Sipas Planit Operacional për Pakon Fiskale Emergjente - COVID-19)



2-1000014641

QIRAMARRËSI:

Periodha	<input type="text" value="Prill - Maj 2020"/>	Data e deklarimit	<input type="text" value="18/04/2020 21:10"/>
NUI / NRF	<input type="text" value="601138177"/>		
Emri i tatimpaguesit	<input type="text" value="TEST CORP"/>		
Adresa e tatimpaguesit	<input type="text"/>		
Kodi / Aktiviteti	<input type="text" value="6831 / Agjencitë e patundshmërive"/>		
Personi kontaktues	<input type="text"/>	Telefoni	<input type="text"/>

QIRADHËNËSIT:

	Numri i qiradhënësve	Vlera financiare
Qiradhënës	<input type="text" value="1"/>	<input type="text" value="200.00"/>

DEKLARATA DHE DËSHMITË E QIRAMARRËSIT:

Deklaroj se kontrata është lidhur me qiradhënësin para datës 1 Mars 2020 dhe është aktive.

Deklaroj se veprimtaria e biznesit tim është ndikuar negativisht nga situata e emergjencës shëndetësore me vendimet e Qeverisë së Kosovës për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19; në mënyrë direkte (duke u përfshirë në listën e kodeve të veprimtarisë, të cilat janë ndaluar me urdhëresë të MEPTINIS të datës 23 Mars 2020); në mënyrë indirekte.

Në vijim ju lutem sqaroni me fjalë tuaja se si ju ka ndikuar në biznes vendimi i Qeverisë në mënyrë direkte apo indirekte dhe evidentoni të gjitha dëshmitë e mundshme, referuar vendimit të Ministrisë së Financave dhe Transfereve të datës 3 Prill 2020:

Komenti

Figura 6:Kërkesa për kompensim të qirasë, e shkarkuar me shtypjen e butonit "Shtyp Kërkesën"

Klikohet tek butoni "Shto Dëshmitë/Kontratat" për të bashkangjitur kontratat dhe dëshmitë e nevojshme dhe zgjedhim kontratat në fjalë, të deklaruar për kompensim të qirasë (si në fig. 8).

Poashtu, në rastin e kompensimit të qiramarrësve për qiratë e paguara, në butonin “Shto Dëshmitë/Kontratrat” duhet të bashkangjitet edhe dëshmia e pagesës mujore të bërë nga qiramarrësi për qiradhënësinë e tij.

Si dëshmi duhet të ofrojë:

- Nëse qiraja është paguar përmes llogarisë bankare, dëshmi duhet të ofroj transaksionin bankar:
 - kopje të urdhërpagesës (sigurohet në sportelet e bankës) ose
 - dokumentin elektronik të transaksioneve bankare përmes e-banking.
- Nëse qiraja është paguar kesh, dëshmi duhet të ofroj:
 - Librin e arkës ku është evidentuar tërheqja e mjeteve për pagesën e qirasë;
 - Konfirmimin e qiradhënësit se ka pranuar qiranë (fletë dëftesa me të dhënat e të qiradhënësit i cili ka pranuar pagesën)




Figura 7: Faqja për shtimin e kontratës së qirasë




Figura 8:Zgjedhja e kontratave për ngarkim

Pasi të keni bashkangjitur dokumentin në “Shto Dëshmitë/Kontratrat”, duhet të klikoni “Ngarko Dëshmitë/Kontratrat” për tu ngarkuar në sistem, me ç’rast pasi ti ngarkoni mund të shihen sa fajlla i keni ngarkuar dhe madhësinë e tyre(si në fig. 9).

Vërejtje: Kontrata duhet të jetë valide, që nënkupton të jetë e vulosur dhe e nënshkruar nga personi përgjegjës.

Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

Ballina Deklaratat Raportet Sherbimet Profili Ndhimë Kontakti ALB SRB ENG

Dëshmitë/Kontratat e Qirasë

+ Shto Dëshmitë/Kontratat Ngarko Dëshmitë/Kontratat Kthehuni në listë

Total 1 fajlla jane zgjedhur / Madhsia totale: 192.88 Kb

Nr.	Emri	Madhësia	E modifikuar	Lloji
1	Kontrata.pdf	192.88 Kb	21.03.2020 11:30	application/pdf

Figura 9:Kontrata e ngarkuar për qiradhënësin e caktuar

Pas ngarkimit të dokumentit apo kontratës për qiradhënësin e caktuar, shfaqet mesazhi “Dokumentet u ngarkuan me sukses” (si në fig. 10).

Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

Ballina Deklaratat Raportet Sherbimet Profili Ndhimë Kontakti ALB SRB ENG

Dëshmitë/Kontratat e Qirasë

+ Shto Dëshmitë/Kontratat Ngarko Dëshmitë/Kontratat Kthehuni në listë

Total 1 fajlla jane zgjedhur / Madhsia totale: 192.88 Kb **Dokumentat u ngarkuan me sukses**

100%

Nr.	Emri	Madhësia	E modifikuar	Lloji
1	Kontrata.pdf	192.88 Kb	21.03.2020 11:30	application/pdf

Figura 10:Kontrata e ngarkuar me sukses për qiradhënësin e caktuar

Butoni “Kthehuni në listë” na mundëson të shohim listën e të gjitha kontratave të ngarkuara.

Dokumentet mund të shtohen edhe më vonë, në listën e kërkesave për kompensim të qirasë (fig. 2), përmes butonit “Ngarko Dëshmitë/Kontratat”, duke selektuar kërkesën e krijuar paraprakisht.

SHTOJCA 1 – Kompensimi i qiramarrësve

Qiramarrësit, të cilët kanë bërë pagesën e qirave, kanë të drejtë kompensimi të shumës që i dedikohet atij qiradhënësi, në bazë të masës 3b. Kjo do të thotë që në rastin kur qiramarrësi ka paguar qiradhënësin, kjo shumë do t’i dërgohet në llogari të qiramarrësit, nëse është në pajtim me kushtet e paraqitura më lartë nga Pani Operacional i Pakos Emergjente Fiskale.

Për t’u bërë kompensimi, qiramarrësi duhet të ofrojë dëshmitë se me të vërtetë janë bërë pagesat e qirave paraprakisht. Llojet e dëshmive që duhet të paraqiten dhe vendi i ngarkimit të dëshmive është sqaruar në faqen 9 të këtij udhëzuesi. *Ju lutem keni parasysh që në Excel fajll të listohen të gjithë qiradhënësit për të cilët kërkohet kompensim në bazë të kushteve dhe udhëzimeve të mësipërme.*

Mirëpo, kompensimi në llogari të qiramarrësit bëhet vetëm për qiradhënësit e paraqitur në Excel fajll, për të cilët dërgohet dëshmia e kryerjes së pagesës së plotë mujore ndaj tyre.

Për të marr parasysh kërkesën tuaj, ju lutem në fushën ku arsyetoni ndikimin e vendimeve të Qeverisë në biznesin tuaj (Fig.4), në krye shkruani:

“KOMPENSIM QIRAMARRËSIT”